



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 12.02.2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “KËNDI I LOJRAVE PËR FËMIJË, PROJETI PILOT 4, NË KUADËR TË REHABILITIMIT TË PARKUT TË LIQENIT, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, dhe Vendimit Nr. 4, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e çështjes dhe zonës me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si Kurora e Gjelbër e Tiranës”, me propozimin e Bashkisë Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Këndi i lojrave për fëmijë, Projekti Pilot 4, në kuadër të rehabilitimit të Parkut të Liqenit, Bashkia Tiranë”, më subjekt kërkues Bashkinë Tiranë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) marrjes së konformitetit nga Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit;
 - c) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA



DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

SAIMIR TAHIRI
ANËTAR I KKT



EDMOND HAXHINASTO
ANËTAR I KKT

ARBEN AHMETAJ
ANËTAR I KKT



YLLI MANJANI
ANËTAR I KKT

MIRELA KUMBARO
ANËTAR I KKT



DAMIAN GJIKNURI
ANËTAR I KKT

EDMOND PANARITI
ANËTAR I KKT



LEFTER KOKA
ANËTAR I KKT

GJON RADOVANI
ANËTAR I KKT
